



KUVENDI I SHQIPËRISË
Komisioni për Politikën e Jashtme

Dokument parlamentar

RAPORT
PËR PROJEKTLIGJIN

**“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË
SË ARABISË SAUDITE, PËR SHËRBIMET AJRORE”**

I. HYRJE

Komisioni për Politikën e Jashtme, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit, shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Arabisë Saudite për shërbimet ajrore”.

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit për të prezantuar projektligjin dhe për t’u dhënë shpjegime pyetjeve të deputetëve ishin përfaqësues të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe të Autoritetit Kombëtar të Aviacionit Civil.

II. QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Qëllimi i projektligjit është ratifikimi i marrëveshjes për shërbimet ajrore, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, dhe qeverisë së Mbretërisë së Arabisë Saudite.

Projektligji vjen pas miratimit në parim të marrëveshjes me vendimin nr.5, datë 09.01.2019, të Këshillit të Ministrave, dhe pas nënshkrimit të marrëveshjes në Riad më 6 shkurt 2019.

Si shtet palë në Konventën mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar ose si njihet ndryshe në Konventën e Çikagos, Republika e Shqipërisë mbart detyrimin që rrjedh nga kjo konventë për koordinimin e veprimtarisë në fushën e aviacionit civil dhe bashkëpunimin në fushën e transportit ajror, mbështetur në parimin e komunikimit ndërmjet vendeve.

Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje synon krijimin e kushteve lehtësuese, nëpërmjet të cilave do të bëhet e mundur lëvizja pa pengesa për shtetasit e të dy vendeve, si dhe do të rritet bashkëpunimi ndërmjet palëve.

Marrëveshja vendos rregullat dhe parimet prej të cilave do të drejtohet ky bashkëpunim dhe siguron një zhvillim progresiv të transportit ndërmjet dy vendeve, të mbështetur në nevojat reciproke komerciale dhe kushtet e hyrjes në tregun e transportit ajror.

Marrëveshja përbëhet nga 37 nene dhe nga shtojca A, në të cilën parashikohen linjat e specifikuara në të dyja shtetet palë, ku përcaktohen linjat ajrore që kanë të drejtë të kryejnë shërbime ajrore ndërkombëtare të planifikuara në të dyja drejtimet.

Në aspektin e **teknikës legislative**, marrëveshja, plotëson kërkesat formale të një marrëveshje dhe për zbatimin e saj do të jetë përgjegjëse Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

III. EFEKTET FINANCIARE

Zbatimi i këtij projektligji nuk përmban efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit, ndërsa sa i takon përjashtimit nga detyrimet doganore dhe detyrimet e tjera, marrëveshja parashikon se çdo palë në bazë të reciprocitetit do të përjashtojë një linjë ajrore të përcaktuar të palës tjetër, në masën më të plotë të mundur në bazë të ligjit të brendshëm, nga detyrimet doganore, taksat dhe detyrimet e tjera.

IV. DISKUTIMI NË KOMISION

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit, për të shpjeguar nismën dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve, ishin përfaqësues të përfaqësues të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Deputetët në komision u informuan rreth qëllimit të projektligjit dhe kushteve të parashikuara në marrëveshje si dhe kërkuan informacion lidhur me përfitimet konkrete të shtetit shqiptar nga ratifikimi i kësaj marrëveshjeje.

Përfaqësuesit e ministrisë sqaruan se kjo marrëveshje, do të vendosë rregullat dhe parimet prej të cilave do të drejtohet një bashkëpunim që do të sigurojë një zhvillim progresiv të transportit ndërmjet dy vendeve, të mbështetur në nevojat reciproke komerciale dhe kushtet e hyrjes në tregun e transportit ajror.

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni me votat e shumicës së anëtarëve të pranishëm e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi dhe u shpreh dakord për kalimin e tij për votim në seancë plenare.

KRYETARE

MIMI KODHELI